39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>GJUHA SHQIPE</i> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës në vlerë prej: 33.643,61 € (Tridhjetë e tremijë e gjashtëqind e dyzet e tre euro dhe gjashtëdhjetë e një cent) në validitet prej 150 ditë</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi dhe menaxheri i projektit do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <i>15 ditë</i>
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit: 10 dite pas nënshkrimit të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>120 ditë</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>0.25%</i> për ditë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të <i>caktohet me vendim të ZKA</i>
Pagesat	24.1	Pagesat do të kryhen në katër (4) situacione. Në situacionin e parë e deri te situacioni i katërt do të kryen pagesat në vlerë prej 100.000,00 €, ndërsa situacioni i katërt dhe i fundit pagesa do të bëhet jo më pak se 10% e vlerës totale të kontratës.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>10 ditë</i> pas nënshkrimit të kontratës.

Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 3 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktues për kompletimin e Punëve, është 10%
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në GJYKATËN THEMELORE në pajtim me ligjin në Kosovë.

RENOVIMI I HAPËSIRËS, LOKACIONI PARKUT TE QYTETIT - LAGJIA DODONA NË PRISHTINË E KORIGJUAR ME 06.04.2020					
Paramasa dhe Parallogaria A. PUNËT E PARKUT					
Kushte të përgjithshme:					
Përshkrimi i punëve. Në përpuethshmëri të plotë me standardet EC dhe ISO.					
Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këte mënyrë duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinare në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve Materialët nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtes.					
Punishja të rrethohet me tabela prej llumarine dhe me konstrukcion të përfuruar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parashoh edhe çfaqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikrijen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve eksistuese te cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.					
Për çdo ndryshim të mundshëm në projekt gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikëqyrës dhe projektantin.					
Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.					
Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vuarjen në vepër të materialeve për secilin pozicion					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total (€)
1	PUNIMET PËRGADITORE				
1.2	Ndërtimi i punishtës që përfshinë: a) Zyra e përkohshme e ndërmarrjes më së paku 2 ndarje, secila ndarje duhet të ketë së paku sipërfaqe S=12m2, me nyle sanitare si dhe e kështu në furnizimin me energji të pandërprerë elektrike dhe të ujit. Zyra duhet të ketë lidhje në kanalizimin publik funksional ose në një rezervuar ekologjik mobil b) Zyra për organin mbikëqyrës (minimum S=16m2), një tavolinë pune me minimum 6 karriga pune për gjatë gjithë kohës së ndërtimit c) WC ekologjike mobile për stafin punues eksekutiv për gjatë gjithë kohës së ndërtimit d) Furnizimi i zyrës me lidhje për komunikim: telefon, faks dhe internet për gjatë gjithë kohës së ndërtimit.	cope	1.00	3,500.00	3,500.00
1.9	Egzaminimi i materialeve dhe bazës së sheshit para dhe pas vuarjes në vepër të tyre si psh. tamponit , gurit të granitit dhe elementeve tjera te cilat planifikohen per shqyrtim ne kete projekt. . <i>Te gjitha produktet jane me origjine nga shtetet anetare te EU dhe ne asnje menyre nga shtetet tjera. Per te gjitha keto do te kete perkujdesje te veqante nga projektanti dhe ekipi mbikqyres.</i>	p.s.	1.00	300.00	300
				Shuma 1:	3,800.00 €

VËREJTJE

	Klasa e betonit per te gjitha pozicionet eshte C30/37. Te gjitha atestet dhe shqyrtimet e nevojshme te perfshihen ne cimin (numri i shqyrtimeve caktohet nga organi mbikqyres). Te gjitha panellet (kallepet) e pjeseve te dukshme te betonit te lyhen dhe te jere te kualitetit te larte ne menyre qe te permbushen edhe kriteriet e larta vizual-estetike te siperfaqeve te betonuara.Kriteret estetike te permbushen edhe gjate betonimit te shkalleve, tribinave, rampave - te gjitha siperfaqeve te dukshme.
	Lloji i armaturave të përdorura janë Sipas detaleve ne projekt: Armatura S-500H

3	SHTEGU I VRAPIMIT				
3.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Furnizimi me material për vedosjen e tabelës në dy vende me emrat e investitorit,ndërmarrjes projektuese dhe ndërmarrjes ndertuese, vleres investuese dhe fillimin dhe mbarimin e projektit. Tabela duhet te punohet nga materialet e kualitetit te larte dhe me shtyp te kualitetit te mire per dukje te qarte nga distanca e larget. Te gjitha duhet te punohen me udhezime nga mbikqyresi i punimeve.	cope	2.00	9,000.00	18,000.00
3.2	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të logaritit edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujërave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontraktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjësin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveq çmimit që kontraktori oferton në kete pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që te furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.	m²	650.00	0.50	325.00
3.3	Incizimi gjeodezik i lokacionit Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe percjellja e puneve ne vazhdimsi me instrumentet gjeodezike.	m2	650.00	2.50	1,625.00 €
3.4	Shënjezimi i instalimeve nëntokore te cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjezimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për ndërtimin e sheshit dhe në vendet e caktuara nga projekti ideor.	p.s	1	150.00	150.00
3.5	Pastrimi, grumbullimi dhe seperimi i te gjitha mbeturinave qe gjenden ne kete siperfaqe per trajtim, materialet largohen ne deponi legale deri në 20 km, te percaktuar nga organi mbikqyres.	m2	650.00	4.00	2,600.00 €
3.6	Germimi i dheut te kategorie III-IV per punimin e shtresave te shetitoret, hapsirat e lodrave, shkallet dhe themelet e fushes se sportit.Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në në deponin e autorizuar ne distance 20 km.	m³	650.00	5.00	3,250.00 €
3.7	Planifikimi dhe kompaktesimi i siperfaqeve te eskavuara, para hudhjes se materialit mbushes me modul të ngjeshjes 20Mpa	m²	650.00	1.50	975.00 €
3.8	Furnizimi dhe vendosja e Gjeotekstil 300 gr/m² nën stazat e ecjes dhe pjeset tjera .	m²	650.00	0.90	585.00 €

3.9	Blerja, furnizimi , planifikimi dhe kompaktesimi I materialit zhavorik për mbushje çakli (0-150) me modul të ngjeshjes 70 Mpa. Materiali perdoret te fsha dhe ne hapsirat e lodrave.	m³	195.00	8.00	1,560.00 €
3.91	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-60mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktesimi 80 Mpa,t=20 cm. Në çnim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Materiali perdoret ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	130.00	12.00	1,560.00 €
3.92	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-30mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktesimi 100 Mpa,t=10cm. Materiali perdoret ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	65.00	9.00	585.00 €
3.93	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi I kallupimeve per punimin e pllakes se fushes se sportit (voljebolli) me trashesi t=15.0 cm , Rrafshimi duhet te behet me makina perkatese .Klasa e betonit C 30 /37 me additive ndaj pershkueshmeris nga uji.	m³	79.40	72.00	5,716.80 €
3.94	Furnizimi me material si, pregatitja dhe vendosja e rrjetave Q-335 ne siperfaqen e hapësirës per muret beton arme t=20.0 cm me palim se paku 30 cm', ne një shtresa	kg	5,952.00	0.65	3,868.80 €
3.95	Punimi I stazes per vrapim me L =310 m dhe gjersi b=2.0 m duhet të parashihet edhe nën baza prej betonit te klases C-30/37 Mpa me trashesi minimale 10 cm, e armuar me rrjetë Q-188 si dhe të punohen ramjet e sipërfaqeve sipas projektit.	m²	620.00	8.00	4,960.00 €
3.96	Pergatitja e dyshemese për stazën e vrapimit. 1. Geryerja,pastrimi i pluhurit, mbushja e gropezave eventuale etj. 2. Shtrirja e primerit Polaplast P10 me baze poliuretani ne trashesi 1.0 mm. 3. Vendosja e gomes se bluar SBR me granulacion 1-4 mm e cila perzihet me ngjites poliuretani Polaplast P 13, trashesia 11-13 mm. 4. Shtrirja behet me makine speciale (finisher). 5. Shtrirja e poliuretanit dy komponentesh Polaplast P12 me ngjyre dhe granulave te gomes me ngjyre EPDM ne trashesi rreth 2.0 mm. Shtrirja behet me makine me sperkatje (spraycoat). 6. Planifikimi dhe ngjyrosja e vijave me PU Line marketing.	m²	620.00	17.00	10,540.00 €
Totali shtegu i vrapimit				56,300.60	

	Paisjet për fitness dhe rekreim në hapësirë të hapur. Paisjet të jenë të prodhuara fabrikisht nga prodhuesi i specializuar në këtë lloj të prodhimit me produkte të kualitetit të lartë me siguri të posaçme të shfrytëzimit të produktit, me funksionalizim, dizajn atraktiv dhe rezistencë të madhe ndaj vandalizmit dhe kushteve atmosferike. Të gjitha paisjet të jenë të punuara sipas standardeve ISO 14001 dhe ISO 9001. Produkti të mos përmbajë kimikale të dëmshme. Çdo paisje të përmbajë udhëzimin e përdorimit dhe përshkrimin e funksioneve. Konstruksioni bazë i produkteve të jetë nga çeliku, të mbrojtura me ngjyrë ekologjike me sistem pudër ose zallim, të gjitha në ngjyrë orange. Çmimi përfshin furnizimin, transportin dhe montimin në tërësi sipas udhëzimit të prodhuesit.				
4.1	Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontraktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjesin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveq çmimit që kontraktori oferton në kete pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që te furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.	m ²	587.00	0.50	293.50
4.2	Inçizimi gjeodezik i lokacionit Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe percjellja e puneve ne vazhdimsi me instrumentet gjeodezike.	m2	587.00	2.50	1,467.50 €
4.3	Shënjezimi i instalimeve nëntoksore te cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjezimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për ndërtimin e sheshit dhe në vendet e caktuara nga projekti ideor.	p.s	1	100.00	100.00
4.4	Pastrimi, grumbullimi dhe seperiimi i te gjitha mbeturinave qe gjenden ne kete siperfaqe per trajtim, materialet largohen ne deponi legale deri në 20 km, te percaktuar nga organi mbikqyres.	m2	587.00	2.50	1,467.50 €
4.5	Germimi i dheut te kategorise III-IV per punimin e shtresave te shetitoret, hapsirat e lodrave, shkallet dhe themelet e fushes se sportit.Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në në deponin e autorizuar ne distance 20 km.	m ³	587.00	3.00	1,761.00 €
4.6	Planifikimi dhe kompakesimi i siperfaqeve te eskavuara, para hudhjes se materialit mbushes me modul të ngjeshjes 20Mpa	m ²	587.00	1.50	880.50 €
4.7	Furnizimi dhe vendosja e Gjeotekstil 300 gr/m ² nën stazat e ecjes dhe pjeset tjera .	m ²	587.00	0.90	528.30 €
4.8	Blerja, furnizimi , planifikimi dhe kompakesimi i materialit zhavorik për mbushje çakli (0-150) me modul të ngjeshjes 70 Mpa. Materiali perdoret te fysha dhe ne hapsirat e lodrave.	m ³	176.10	9.00	1,584.90 €
4.9	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyesi d=0-60mm, mbushjet, planifikimi dhe kompakesimi 80 Mpa,t=20 cm. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Materiali perdoret ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m ³	117.40	12.00	1,408.80 €

4.91	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurtthyesi d=0-30mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktësimi 100 Mpa,t=10cm. Materiali perdoret ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	58.70	9.00	528.30 €
4.92	Sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi me Beton C-20/25 MPa, mirëmbajtja e betonit për punimin e shtresave mbrojtëse te armatures me trashësi mesatare t=5.0 cm nen pllaken BA te fushave sportive , këndit të fitnesit	m³	29.35	25.00	733.75 €
4.93	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve per punimin i hapësirave per fitnes C30/37 me t=20 cm .Rrafshimi dhe tekstura e siperfaqes se betonit duhet te jet e paster.	m³	117.40	68.00	7,983.20 €
4.94	Furnizimi me material si, pregaditja dhe vendosja e rrjetave Q-335 ne siperfaqen e hapësirës per fitnes ne pllaken beton arme t=20.0 cm me palim se paku 40 cm', ne dy shtresa	kg	8,805.00	0.65	5,723.25 €
4.95	Pergatitja e dyshemese për paisjet e fitnesit . 1. Geryerja,pastrimi i pluhurit, mbushja e gropezave eventuale etj. 2. Shtrirja e primerit Polaplast P10 me baze poliuoretani ne trashësi 1.0 mm. 3. Vendosja e gomes se bluar SBR me granulacion 1-4 mm e cila perzihet me ngjites poliuoretani Polaplast P 13, trashësia 11-13 mm. 4. Shtrirja behet me makine speciale (finisher). 5. Shtrirja e poliuretanit dy komponentesh Polaplast P12 me ngjyre dhe granulave te gomes me ngjyre EPDM ne trashësi rreth 2.0 mm. Shtrirja behet me makine me sperkatje (spraycoat). 6. Planifikimi dhe ngjyrosja e vijave me PU Line marketing.	m²	590.00	5.00	2,950.00 €
4.96	Furnizimi me material dhe punimi i gomes (fitnes) , sipas kesaj renditje 1.Shtruerja e shtresës nga betoni i armuar me trashësi 15cm me armaturë rrejtë Q-355 (betoni dhe rrjetat janë e llogaritur ne pozicionet e mesipërme) duke punuar dilatimet e nevojshme me modul 24m² (për fushë të sportit dhe kënde te lodrave) ndërsa çdo 6m' për stazat e ecjes. Betonit ti shtohet aditivi për rezistencë ndaj lageshtisë.Ti kushtohet kujdes nivelimit dhe evitimit të gropave dhe deformimeve gjatë betonimit. 2.Punimi i dyshemesë nga goma me shtresë të dyfishtë : sistemi me sperkatje (spraycoat). Struktura bazë të jetë e punuar nga granulat SBR -gomë e recikluar 1-3,5 mm , e ngjitur me ngjites adekuat dhe shtresa e epërme me stërkije me poliuretan dhe granula EPDM :0,5 - 1,5 mm dhe EPDM puder 0.0 -0,5mm-dy herë. Produkti ti plotësojë standardet DIN V 18035-6, EN-14 977, IAAF ose të ngjajshme. Trashësia e tërë shtresave min. 13 -14 mm. Të gjitha shtresat e dyshemesë të jenë sistem i një prodhuesi duke përfshirë edhe ngjitesat adekuat. Ky pozicion të realizohet meedomos nga stafi profesional i trajnuar për realizim të produktit dhe në tërësi sipas udhëzimeve të prodhuesit (temp. minimale dhe temp. maksimale gjatë realizimit, lagështia e ajrit, rreut Uv etj.)përfshirë edhe pastrimin paraprak të bazës dhe pregaditjen e nënbazës . Të ofrohet garancioni në prodhim/material (min. 5 vite) dhe në realizim (min. 3 vite). Obligim i punëkryesit është sigurimi i materialit dhe prodhimit gjatë realizimit dhe mbrojtja nga ndikimet atmosferike (të reshurat, dielli etj.). Kjo dysheme punohet te fusha e s fitnesit . Punëkryesi gjatë ofertimit të prezantojë katalogun e materialit - prodhuesit dhe metodologjinë e realizimit. Pozicioni llogaritet me çnim njësi. Vërejtje: Pjerrësia e terentit duhet të jetë 2-3%	m²	600.00	11.00	6,600.00 €

4.97	Furnizimi me material si dhe montimi i paisjes për fitnes me shtytje në drejtim poshtë lart dy ulëse të vendosura në një shtyllë për fëmijë e dedikuar për moshën mbi 12 vjet (Angl. Push Up Bars). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETAIL I LODRAVE "1")	copë	4.00	450.00	1,800.00 €
4.98	Furnizimi me material si dhe montimi i ulësës për fitnes e dedikuar për moshën mbi 15 vjet (Angl. Pull Down). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETAIL I LODRAVE "2"),	copë	4.00	450.00	1,800.00 €
4.99	Furnizimi me material si dhe montimi i varësve për fitnes të vendosura në një shtyllë për dy persona e dedikuar për moshën mbi 15 vjet (Angl. Upper Body Trainer). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETAIL I LODRAVE "3"),	copë	4.00	480.00	1,920.00 €
5	Furnizimi me material si dhe montimi i varësve për fitnes të vendosura në një shtyllë për dy persona e dedikuar për moshën mbi 15 vjet (Angl. Upper Body Trainer). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETAIL I LODRAVE "4"),	copë	4.00	450.00	1,800.00 €
TOTALI PER PAISJET PER FITNES				41,330.50 €	

5	LOJRAT PËR FËMIJË				
5.1	Kontrollimi dhe evidntimi i instalimeve nëntokore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të logaritit edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontraktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjesin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shesë përveq çmimit që kontraktori oferton në kete pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që te furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.	m²	465.00	0.50	232.50
5.2	Inçizimi gjeodezik i lokacionit Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe percjellja e puneve ne vazhdimsi me instrumentet gjeodezike.	m2	465.00	2.50	1,162.50 €
5.3	Shënjestimi i instalimeve nëntokore te cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjestimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për ndërtimin e sheshit dhe në vendet e caktuara nga projekti ideor.	p.s	1	100.00	100.00
5.4	Pastrimi, grumbullimi dhe seperiimi i te gjitha mbeturinave qe gjenden ne kete siperfaqe per trajtim, materialet largohen ne deponi legale deri në 20 km, te percaktuar nga organi mbikqyres.	m2	465.00	3.00	1,395.00 €

5.5	Germimi i dheut te kategorise III-IV per punimin e shtrësave te shetitoret, hapsirat e lodrave, shkallet dhe themelet e fushes se sportit.Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në në deponin e autorizuar ne distance 20 km.	m³	465.00	3.00	1,395.00 €
5.6	Planifikimi dhe kompaktësimi i siperfaqeve te eskavuara, para hudhjes se materialit mbushës me modul të ngjeshjes 20Mpa	m²	465.00	1.50	697.50 €
5.7	Furnizimi dhe vendosja e Gjeotekstil 300 gr/m² nën stazat e ecjes dhe pjesët tjera .	m²	465.00	0.90	418.50 €
5.8	Blerja, furnizimi , planifikimi dhe kompaktësimi i materialit zhavorik për mbushje çakli (0-150) me modul të ngjeshjes 70 Mpa. Materiali perdoret te fsha dhe ne hapsirat e lodrave.	m³	139.50	9.00	1,255.50 €
5.81	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-60mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktësimi 80 Mpa,t=20 cm. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Materiali perdoret ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	93.00	9.00	837.00 €
5.82	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-30mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktësimi 100 Mpa,t=10cm. Materiali perdoret ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	46.50	9.00	418.50 €
5.83	Sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi me Beton C-20/25 MPa, mirëmbajtja e betonit për punimin e shtrësve mbrojtëse te armatues me trashësi mesatare t=5.0 cm nen plaken BA te lojravee per femije	m³	23.25	12.00	279.00 €
5.84	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve per punimin i hapësirave per fitnes C30/37 me t=20 cm .Rrafshimi dhe tekstura e siperfaqes se betonit duhet te jet e paster.	m³	93.00	75.00	6,975.00 €
5.85	Furnizimi me material si, pregaditja dhe vendosja e rrjetave Q-335 ne siperfaqen e hapësirës per fitnes ne plaken beton arme t=20.0 cm me palim se paku 40 cm', ne dy shtresa	kg	6,975.00	0.65	4,533.75 €

5.86	Furnizimi me material dhe punimi i gomes , sipas kesaj renditje 1.Shtruerja e shtresës nga betoni i armuar me trashësi 15cm me armaturë rrejtë Q-355 (betoni dhe rrijetat janë e llogaritur ne pozicionet e mesipërme) duke punuar dilatimet e nevojshme me modul 24m² (për fushë të sportit dhe kënde te lodrave) ndërsa çdo 6m² për stazat e ecjes. Betonit ti shtohet aditivi për rezistencë ndaj lageshtisë.Ti kushtohet kujdes nivelimit dhe evitimit të gropave dhe deformimeve gjatë betonimit. 2.Punimi i dyshemesë nga goma me shtresë të dyfishtë : sistemi me spërkatje (spraycoat). Struktura bazë të jetë e punuar nga granulat SBR -gomë e reclusuar 1-3,5 mm , e ngjitur me ngjithës adekuat dhe shtresa e epërme me stërkijë me poliuretan dhe granula EPDM :0,5 - 1,5 mm dhe EPDM puder 0.0 -0,5mm-dy herë. Produkti ti plotësojë standardet DIN V 18035-6, EN-14 977, IAAF ose të ngjajshme. Trashësia e tërë shtresave min. 13 -14 mm. Të gjitha shtresat e dyshemesë të jenë sistem i një prodhuesi duke përfshirë edhe ngjithësat adekuat. Ky pozicion të realizohet meçomos nga stafi profesional i trajnuar për realizim të produktit dhe në tërësi sipas udhëzimeve të prodhuesit (temp. minimale dhe temp. maksimale gjatë realizimit, lagështia e ajrit, rreret Uv etj.)përfshirë edhe pastrimin paraprak të bazës dhe pregaditjen e nënbazës . Të ofrohet garancioni në prodhim/material (min. 5 vite) dhe në realizim (min. 3 vite). Obligim i punëkryesit është sigurimi i materialit dhe prodhimit gjatë realizimit dhe mbrojtja nga ndikimet atmosferike (të reshurat, dielli etj.). Kjo dysheme punohet te fusha e s fitnesit . Punëkryesi gjatë ofertimit të prezantojë katalogun e materialit - prodhuesit dhe metodologjinë e realizimit. Pozicioni llogaritet me çmim njësi. Vërejtje: Pjerrtësia e terenit duhet të jetë 2-3%	m²	600.00	16.00	9,600.00 €
5.87	Furnizimi me material si dhe montimi i luhatësës për fëmijë të vegjël (swings). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (LUHATËSJA),	copë	3.00	310.00	930.00 €
5.88	Furnizimi me material si dhe montimi i lodrave për fëmijë të vegjël paraleles per ngritje poshte-larte(seesaws).Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE "6"),	copë	3.00	250.00	750.00 €
5.89	Furnizimi me material si dhe montimi i lodrave për fëmijë të vegjël, lodrat me suste per levizje (Ang. Springers). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE "8" dhe "9"),	copë	3.00	250.00	750.00 €
5.9	Furnizimi me material si dhe montimi i lodres se ashtuquajtur „KULLA" për fëmijë të vegjël, lodrat m Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiqo detalin: (DETALI I LODRAVE)	copë	1.00	400.00	400.00 €
TOTALI PËR LODRAT PËR FËMIJË					32,129.75 €

A	FUSHA E FUTBOLLIT (Ekzistuese :Renovohet)			
	Furnizimi me material, punimi si dhe montimi i tabelës informuese në hyrje të tereneve sportive. Tabela duhet të përmbajë tekstin sipas kërkesës së investitorit. Tabela i përshkrahë aktivitetet si vijon: - Gërmimi, shtruerja e zavorit, armimi si dhe betonimi i themeleve për ankerimin e shtyllave të tabelës informuese me dimensione (50x30x30)cm, shtyllat prej profileve metalike me diametër 48.3mm /2.6mm, korniza mbajtëse për tabelë me profile HOP 40X40/2.0mm, si dhe tabela prej pllakës prej alumini të plastifikuar me trashësi 2mm (dy plaka) me ngjyrë të përcaktuar nga investitori. Në çmim duhet të llogaritet edhe teksti i cili duhet të shkruhet me ngjyrë të rezistueshme për ambient të jashtëm. Të gjitha punët, materialet si dhe materialet e imëta të nevojshme për këtë aktivitet duhet të realizohen si pas detajit të bashkangjitur.	Copë	1.00	350.00
1				350.00 €
2	Furnizimi me material dhe montimi i ndriçuesve reflektor për panot me mbishkrim duke përfshirë edhe kablion furnizuese dhe të gjitha punët, materialet si dhe materialet e imëta të nevojshme për këtë aktivitet.	copë	1.00	150.00
				150.00 €
3	Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntokore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detaj operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontaktori duhet të ofroj plan detaj të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha harghimet mban përgjegjesin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vetë kosto shtesë përveç çmimit që kontraktori oferton në këtë pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që të furnizoi vet institucionet publike dhe lokalitet afariste përmas kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmas një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.	m ²	300.00	0.50
				150.00
4	Incizimi gjeodezik i lokacionit Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe përcjellja e punëve në vazhdimi me instrumentet gjeodezike.	m2	300.00	2.50
				750.00 €
5	Shënjestimi i instalimeve nëntokore të cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjestimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për ndërtimin e sheshit dhe në vendet e caktuara nga projekti ideor.	p.s	1	100.00
				100.00
6	Pastrimi, grumbullimi dhe seperiimi i të gjitha mbeturinave që gjenden në këtë sipërfaqe per trajtim, materialet largohen në deponi legale deri në 20 km, të percaktuar nga organi mbikqyres.	m2	300.00	3.00
				900.00 €
7	Gërmimi i dheut të kategorise III-IV per punimin e shtresave te shetitoret, hapsirat e lodrave, shkallet dhe themelet e fushes se sportit.Pozicioni përshkrahë edhe transportin e materialit të tepërt deri në deponin e autorizuar në distance 20 km.	m ³	300.00	3.00
				900.00 €
8	Planifikimi dhe kompaktimi i sipërfaqeve të eskavuara, para hudhjes se materialit mbushes me modul të ngjeshjes 20Mpa	m ²	300.00	1.50
				450.00 €
9	Furnizimi dhe vendosja e Gjeotekstil 300 gr/m ² nën stazat e ecjes dhe pjeset tjera .	m ²	300.00	0.90
				270.00 €
10	Blerja, furnizimi , planifikimi dhe kompaktimi i materialit zhavorik për mbushje çakli (0-150) me modul të ngjeshjes 70 Mpa. Material perdoret te fysha dhe ne hapsirat e lodrave.	m ³	90.00	9.00
				810.00 €

11	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyresi d=0-60mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktimesi 80 Mpa,t=20 cm. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Materiali përdoret në staza për kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	60.00	12.00	720.00 €
12	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyresi d=0-30mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktimesi 100 Mpa,t=10cm. Materiali përdoret në staza për kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	30.00	9.00	270.00 €
13	Sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi me Beton C-20/25 MPa, mirëmbajtja e betonit për punimin e shtresave mbrojtëse të armatues me trashësi mesatare t=5.0 cm nën pillakën BA të fushave sportive, këndit të fitnesit	m³	40.00	30.00	1,200.00 €
14	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve për punimin e murit mbrojtës beton armë, tribinave për spektator dhe elementeve tjera konstruktive. Rrafshimi dhe tekstura e sipërfaqes së betonit duhet të jetë e pastër.Klasa e betonit C 30 /37 me aditive ndaj përshkueshmëris nga uji.	m³	170.00	65.00	11,050.00 €
15	Furnizimi dhe betonimi i stazes së vrapimit në perimete të fushës së futbollit me gjersi 1.5 m.Klasa e betonit C 30 /37 me aditive ndaj përshkueshmëris nga uji.	m³	30.00	75.00	2,250.00 €
16	Furnizimi me material si, pregatitja dhe vendosja në vend e armatues për themelet, shkalleve, tribinave në formë shkallësh sipas llogaris statike dhe spec. teknik.	kg	13,600.00	0.65	8,840.00 €
17	Furnizimi dhe montimi i portes së footballit me dimensione sipas vizatimit në detal të prodhuara nga shtylla të celikut me seksione ovale 120 X100 mm, skajet gjithashtu duhet të jenë të forcuara. Në çmim duhet të përfshihen edhe ankeret nga celiku komplet me kapak dhe shufrat e hekurta të ngjyrosura që shërbejnë për forcimin e rrjetës, si dhe rrjeta. Lartësia,vendi dhe gjatësia e vendosjes së shtyllave do të bëhet sipas normave sportive.	copë	2.00	150.00	300.00 €
18	Furnizimi me material si dhe punimi i vijave për football. Pozicioni përfshinë të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional, të gjitha materialet duhet të plotësojnë standardet teknike evropiane të parapara për këtë aktivitet. Llogaritja bëhet për m².	m²	275.00	2.50	687.50 €
19	Pergatitja e dyshemese për fushën e futbollit, 1. Geryerja,pastrimi i pluhurit, mbushja e gropëzave eventuale etj. 2. Shtirja e primerit Polaplast P10 me baze poliuretani në trashësi 1.0 mm. 3. Vendosja e gomes së bluar SBR me granulacion 1-4 mm e cila perzihet me ngjites poliuretani Polaplast P 13, trashësia 11-13 mm. 4. Shtirja behet me makine speciale (finisher). 5. Shtirja e poliuretanit dy komponentesh Polaplast P12 me ngjyre dhe granulave te gomes me ngjyre EPDM ne trashësi rreth 2.0 mm. Shtirja behet me makine me sperkatje (spraycoat). 6. Planifikimi dhe ngjyrosja e vijave me PU Line marketing.	m²	350.00	5.00	1,750.00 €

20	Furnizimi , prerja, saldimi dhe punimi i rrethojes metalike sipas detalit në projekt. Lartësia e rrethojes është H=4.10 m. Në pozicion të përfshihen ankerimet e nevojshme, saldimet, shtyllat vertikale, horizontalet, mbushjen me rrjet Ø8 qdo 15 cm të kufizuara me profila L , pllakat lidhëse mbyllësat përfundimtare, lyeraja me një ngjyrë dhe dy shtresa finale nuanca e gjelbërt. Llogria në m² të rrethojes. Vërejtje :shiqo detalin (Detali i Rrjetës,) (Fusha e futbollit dhe basketbollit , voljebollit)	m²	300.00	15.00	4,500.00 €
21	Furnizimi, prerja, saldimi dhe vendosja e derës hyrëse dy krishe me dimensione 255x400 cm, te inkuadruar në rrethojen nga materiali dhe dizajni i njejtë si i rrethojes, në çmim të llogariten ngjyrosja dhe mekanizimi për hapje dhe mbyllje. Vërejtje :shiqo detalin.	m²	10.20	50.00	510.00 €
22	Furnizimi me material dhe montimi i drurëve (bungu i impregnuar) me dimensione 5X5 cm në 8 rende dhe gjatësia 1m' të vendosur me bulona antikorroziv me kokë të rrumbullakët sipër konstruksionit metalik në formë "U" të cilat i kanë dy vrima ku do të vendosen në beton me bulonat me tiplla M10 me dimensione 5-7 mm dhe gjatësi 70 mm. Sipas vizatimeve në projekt të cilat montohen afër njëra tjetrës mbi tribuna dhe tek këndet e lojërave. (Shiqo vizatimin në përshkrim dhe vizatime). Llogaritja në copë për çdo 1 m' të drurëve. Në çmim parashihet edhe mirembajtja e drurëve, lyerja, mirembajtja me masa mbrojtëse ndaj lageshtisë dhe kushteve atmosferike.	copë	882.00	0.50	441.00 €
TOTALI PËR FUSHEN E FUTBOLLIT					37,348.50 €

B	FUSHA E BASKETBOLLIT				
1	Inçizimi gjeodezik i lokacionit Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe percjellja e puneve ne vazhdimsi me instrumentet gjeodezike.	m2	250.00	2.50	625.00 €
2	Shënjestrimi i instalimeve nëntoksore te cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjestrimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për ndërtimin e sheshit dhe në vendet e caktuara nga projekti ideor.	p.s	1	150.00	150.00
3	Pastrimi, grumbullimi dhe seperiimi i te gjitha mbeturinave qe gjenden ne kete siperfaqe per trajtim, materialet largohen ne deponi legale deri në 20 km, te percaktuar nga organi mbikqyres.	m2	250.00	3.00	750.00 €
4	Germimi i dheut te kategorise III-IV per punimin e fushës së sportit , themelet e rrethojës së fushes se sportit.Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në deponin e autorizuar ne distance 20 km.	m³	250.00	3.00	750.00 €

5	Planifikimi dhe kompaktimi i siperfaqeve te eskavuara, para hudhjes se materialit mbushes me modul të ngjeshjes 20Mpa	m ²	250.00	1.50	375.00 €
6	Furnizimi dhe vendosja e Gjeotekstil 300 gr/m ² nën stazat e ecjes dhe pjeset tjera .	m ²	250.00	0.90	225.00 €
7	Blerja, furnizimi , planifikimi dhe kompaktimi i materialit zhavorik për mbushje çakli (0-150) me modul të ngjeshjes 70 Mpa. Materiali perdozet te fusha dhe ne hapsirat e lodrave.	m ³	90.00	9.00	810.00 €
8	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-60mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktimi 80 Mpa,t=20 cm. Në çnim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Materiali perdozet ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m ³	60.00	12.00	720.00 €
9	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-30mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktimi 100 Mpa,t=10cm. Materiali perdozet ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m ³	30.00	9.00	270.00 €
10	Sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi me Beton C-20/25 MPa, mirëmbajtja e betonit për punimin e shtresave mbrojtëse te armatures me trashësi mesatare t=5.0 cm nen plaken BA te fushave sportive , këndit të fitnesit	m ³	15.00	30.00	450.00 €
11	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve per punimin e fushes se sportit (futbollit), Muret mbrojtëse betona arme, tribinave për spektator dhe elementeve tjera kosntruktive. Rrafshimi dhe tekstura e siperfaqes se betonit duhet te jet e paster.Klasa e betonit C 30 /37 me aditive ndaj pershueshmeris nga uji.	m ³	60.00	75.00	4,500.00 €
12	Furnizimi me material si, pregaditja dhe vendosja ne vend e armatures për themelet e rrethojës, pllakes (Q524)së dyshemeve nga goma sipas llogaris statike dhe spec. teknik.	kg	4,800.00	0.65	3,120.00 €
13	Furnizimi me material, rrafshimi dhe nivelizimi i shtrese se sipërme te betonit me paisjen e ashtuquajtur „ Helikopter“ Vrejteje : Të konsultohet eksperti i shtruarjes se dyshemes nga goma	m ²	230.00	2.00	460.00 €
14	Furnizimi, Punimi dhe montimi i konstruksionit metalik me diametër Ø125mm duke përfshirë tabelen e basketbollit (PER AMBIJENT TE JASHTEM SIPAS FIBAS) duke llogaritur edhe përforcimet në bazament me pllaka të hekurit 400 x 400 x10mm, ankorimin e bulonave Ø20mm gjatësi 80cm vendosjen-saldimin e pllakës me konstruksion metalik 400x 400 x 10mm. Vërejtje: Për shtylla duhet të punohet edhe bazamenti nga betoni armeja C-25/30 me dim.100 x 100 x 80cm duke llogaritur edhe tamponin nën bazament me trashësi t=20cm. Lartësia,vendi dhe gjatësia e vendosjes së shtyllave do të bëhet sipas normave sportive. Të përfshihen të gjitha ankerimet e nevojshme për këtë pozicion.	copë	2.00	250.00	500.00 €
15	Furnizimi me material si dhe montimi i unazës së koshit me susta, në çnim duhet të parashihet edhe rrjeta për unazë të basketbollit në përputhje me standartet teknike te FIBA-së .	copë	2.00	45.00	90.00 €

16	Furnizimi me material si dhe punimi i vijave për basketboll. dhe vollarit Pozicioni përfshinë të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional, të gjitha materialet duhet të plotësojnë standardet teknike evropiane të parapara për këtë aktivitet. Llogaritja bëhet për m'.	m'	525.00	0.90	472.50 €
17	Furnizimi , prerja, saldimi dhe punimi i rrethojës metalike sipas detalit në projekt. Lartësia e rrethojës është H=4.10 m. Në pozicion të përfshihen ankimet e nevojshme, saldime, shtyllat vertikale, horizontale, mbushjen me rrjet Ø8 qdo 15 cm të kufizuara me profila L , pllakat lidhëse mbyllësat përfundimtare, lverja me një ngjyrë dhe dy shtresa finale nuanca e gjelbërt. Llogria në m² të rrethojës. Vërejtje :shiqo detalin (Detali i Rrjetës,) (Fusha e futbollit dhe basketbollit , voljebollit)	m²	350.00	45.00	15,750.00 €
18	Furnizimi, prerja, saldimi dhe vendosja e derës hyrëse dy krishe me dimensione 255x400 cm, te inkuadruar në rrethojen nga materiali dhe dizajni i njëjtë si i rrethojës, në çmim të llogariten ngjyrosja dhe mekanizimi për hapje dhe mbyllje. Vërejtje :shiqo detalin.	m²	10.20	270.00	2,754.00 €
19	Punimi i fushes së basketbollit, 1. Geryerja,pastrimi i pluhurit, mbushja e gropave eventuale etj. 2. Shtirja e primerit (bazës) Rithvex 1102, 3. Shtirja e shtresës rrafshuese elastike Elastospot 853 4. Shtirja e shtresës elastike Elastocoat 842 (Coarse + Fine) ne dy shtresa 5. Shtirja e shtresës kryesore Elastoturf 851 coloured ne dy shtresa 6. Shtirja e shtresës ngjyrosese Elastomark 818. 7. Planifikimi dhe ngjyrosja e vijave me Elastomark 818.	m²	200.00	16.00	3,200.00 €
TOTALI PËR FUSHEN E BASKETBOLLIT				35,971.50 €	

C	FUSHA E VOLJEBOLLIT				
1	Inçizimi gjeodezik i lokacionit Sipas Specifikacioneve teknike, si dhe percjellja e punëve ne vazhdimsi me instrumentet gjeodezike.	m2	350.00	2.50	875.00 €
2	Shënjestimi i instalimeve nëntokore te cilat nuk çvendosen nga pozicioni ekzistues. Të bëhet edhe shënjestimi i lokacionit para fillimit të punimeve ku parashihet lokacioni për ndërtimin e sheshit dhe në vendet e caktuara nga projekti ideor.	p.s	1	100.00	100.00
3	Pastrimi, grumbullimi dhe seperiimi i te gjitha mbeturinave qe gjenden ne kete siperfaqe per trajtim, materialet largohen ne deponi legale deri ne 20 km, te percaktuar nga organi mbikqyres.	m2	350.00	3.00	1,050.00 €


4	Germimi i dheut te kategorise III-IV per punimin e fushës së sportit , themelet e rrethojës së fushes se sportit.Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në deponin e autorizuar ne distance 20 km.	m³	350.00	3.00	1,050.00 €
5	Planifikimi dhe kompaktesimi i siperfaqeve te eskavuara, para hudhjes se materialit mbushes me modul të ngjeshjes 20Mpa	m²	350.00	1.50	525.00 €
6	Furnizimi dhe vendosja e Gjeotekstil 300 gr/m² nën stazat e ecjes dhe pjeset tjera .	m²	350.00	0.90	315.00 €
7	Blerja, furnizimi , planifikimi dhe kompaktesimi i materialit zhavorik për mbushje çakli (0-150) me modul të ngjeshjes 70 Mpa. Materiali perdoret te fsha dhe ne hapsirat e lodrave.	m³	120.00	9.00	1,080.00 €
8	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-60mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktesimi 80 Mpa,t=20 cm. Në çmim të parashihen edhe të gjitha shpenzimet e nevojshme për shqyrtimin e ngjeshmërisë. Materiali perdoret ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	80.00	12.00	960.00 €
9	Blerja, furnizimi me zhavor nga gurthyysi d=0-30mm, mbushjet, planifikimi dhe kompaktesimi 100 Mpa,t=10cm. Materiali perdoret ne staza per kembesor, kendet e lodrave, shkallet dhe fusha e sportit.	m³	40.00	9.00	360.00 €
10	Sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi me Beton C-20/25 MPa, mirëmbajtja e betonit për punimin e shtresave mbrojtese te armatures me trashesi mesatare t=5.0 cm nen plaken BA te fushave sportive , këndit të fitnesit	m³	20.00	30.00	600.00 €
11	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve per punimin e fushes se sportit (futbollit). Muret mbrojtese betona arme, tribinave për spektator dhe elementeve tjera kosntruktive. Rrafshimi dhe tekstura e siperfaqes se betonit duhet te jet e paster.Klasa e betonit C 30 /37 me additive ndaj pershkuesmeris nga uji.	m³	80.00	68.00	5,440.00 €
12	Furnizimi me material si, pregaditja dhe vendosja ne vend e armatures për themelet e rrethojes, pllakes (Q524)së dyshemeve nga goma sipas llogaris statike dhe spec. teknik.	kg	6,400.00	0.65	4,160.00 €
13	Furnizimi dhe montimi i portes se footballit me dimensione sipas vizatimit ne detal te prodhuara nga shylla te celikut me seksione ovale 120 X100 mm, skajet gjithashtu duhet te jene te perforcuara. Ne cmim duhet te perfshihen edhe ankeret nga celiku komplet me kapak dhe shufrat e hekurta te ngjyrosura qe sherbejne per performimin e rrjetes, si dhe rrjeta. Lartësia,vendi dhe gjatësia e vendosjes së shyllave do të bëhet sipas normave sportive.	copë	1.00	150.00	150.00 €
